



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK RAJONAL  
KRYEMINISTRIA**

**Aneks 1: Vendodhja dhe pamja e dyqanit**

**Parime të përgjithshme**

- Dyqani duhet të jetë i pozicionuar në një zonë qendrore të qyteteve dhe të aksesueshme nga turistët vendas dhe të huaj.
- Dyqani duhet të përdorë si lëndë ndërtuese dhe arredeuse, materiale te riciklueshme, dru, kashtë, hekur, gur, etj.
- Ambjentet e brendshme të dyqanit duhet të respektojnë rreptësisht elementët e modelit tip, si më poshtë vijon:

**Specifikime ndërtimore-teknike për dyqane të reja**

- Sipërfaqe e dyqanit e llogaritur rreth 50m<sup>2</sup>
- Konstrukcion mbajtës nëpërmjet: kollona metalike dopio "T", trare lidhëse metalike tubolare. Dhe mbulimi tavanor me panele.
- Mure perimetrale: gips cimentato, dhe mure të brendshme (sipas rastit) gips normal.
- Fasada duhet të trajtohet me suva grafiato & elemente dekorativ prej druri (do të shikohet në bazë të koncept idesë).
- Në një nga fasadat do të kemi reklamimin e logos "EDUA" ose "EDUA Tirana"
- Muret e brendshme do të jenë të lyera me boje mbuluese të bardhë. Në një nga faqet ku mund të ekspozohet logo do të kemi veshje të murit me leter murale (imitim tulle)
- Tavani i lyer me bojë mbuluese të bardhë dhe e pasuruar me trare dekorativ prej druri ose imitacion druri.
- Dyshemeja e shtruar me parket laminat, ose mund te shtrohet me ristela druri të cilat mund te merren nga riciklimi i paletave.

-Ndricimi tavanor është konceptuar me forma gjeometrike që imitojnë elementët tradicional. Nderthurje pesiglas dhe ndricim led në brendesi.

### **Specifikime ndërtimore-teknikë për objekte ekzistues**

Shënim: Në varësi të hapësirës së brendshme duhet të këtë

-Muret e brendshme duhet të jenë të lyera me bojë mbuluese të bardhë. Në një nga faqet ku mund te ekspozohet logo-ja, do të kemi veshje të murit me leter murale (imitim tulle)

-Tavani i lyer me bojë mbuluese të bardhë dhe e pasuruar me trarë dekorativ prej druri ose imitacion druri.

-Dyshemeja e shtruar me parket laminat, ose mund të shtrohet me rristela druri të cilat mund të merren nga paleta.

-Ndricimi tavanor është konceptuar me forma gjeometrike që imitojne elementet tradicionalë. Nderthurje pesiglas dhe ndricim led në brendesi.

**Për nje render vizual më të qartë referoni piken “2. Modeli i dyqanit tip EDUA”**